- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Gusht 2020.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Boshnjaku.B Shpk”, “Pese Vellezerit Shpk” dhe “L.T.E Construction Shpk” është konstatuar se nuk është paraqitur dokumentacion kualifikues për 2 (dy) punonjës si “Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë”. Asnjëri prej anëtarëve të këtij bashkimi nuk ka dorëzuar dokument kualifikues për 2 (dy) punonjës si “Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë”, duke mos plotësuar kërkesën sipas pikës 2.3.3, gërma e të kapaciteti teknik.

c. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3, gërma g dhe h Kapaciteti Teknik, kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

- *Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.A. Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis.*
- *Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.*

Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 2,3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet:

Pika 2: Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Pika 3: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar bazës ligjore të sipërcituar gjykon se përmbushja e kriterëve të veçanta të kualifikimit duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe natyrën e punëve të marra përsipër për realizimin me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se në kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë Licencë me Kodi III.2.A. lëshuar nga QKL e cila ka të bëjë me veprimtarinë Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis dhe Kodi III.2. B lëshuar nga QKL e cila ka të bëjë me veprimtarinë Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Boshnjaku.B Shpk”, “Pese Vellezerit Shpk” dhe “L.T.E Construction Shpk” në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se këto licenca diponohen vetëm nga njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi e konkretisht nga shoqëria “L.T.E Construction Shpk”, dhe rezulton se anëtarët e tjerë të këtij

bashkimi konkretisht Boshnjaku.B Shpk ” dhe “ Pese Vellezerit Shpk ” ,nuk janë të pajisur me këto licenca me Kod III.2.A dhe Kod III.2.B.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.rep 1473 dhe Nr.Kol.666 datë.13.10.2020 secicili nga anëtarë e këtij bashkimi kanë marrë përsipër realizimin e zërave të punëve në bazë të preventivit përkatës, për punime të tilla si:

- Germim dheu
- Pastrim nga dherat
- Punime të ndryshme prishje
- Rrafshim skarpatesh
- Punime murraturë të ndryshme
- Punime Shtresash në Themel
- Të gjithë zërat të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis,

nga të cilat rrjedhimisht do të krijohen mbetje urbane dhe ndikimin në mjedis.

Këto punime për vetë karakterin e tyre ndërhyjnë në eko sistem dhe që kërkojnë te ruhen burimet ujore dhe shmangja e ndërhyrjeve në terrenin përreth . Këto punime detyrimisht janë të shoqeruara edhe me rehabilitimin e territorit.

Për këtë fakt kërkohen domosdoshmërisht licenca me Kod III.2.A. Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis dhe licenca me Kod III.2. B lëshuar nga QKL për objektin e veprimtarisë, “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”, të plotësohet edhe nga anëtarë e tjerë të këtij bashkimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se është pikërisht natyra e punimeve që do të realizohen nga anëtarët e tjerë të këtij bashkimi “Boshnjaku.B Shpk ” dhe “ Pese Vellezerit Shpk ” ku referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet akt-marrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Boshnjaku.B Shpk ”, “ Pese Vellezerit Shpk ” dhe “L.T.E Construction Shpk ” nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për paraqitjen e Licencës me Kod III.2.A dhe me Kod III.2.B është plotësuar vetëm nga njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Në këtë kuptim në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është shprehur qartësisht që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitete e nevojshme teknike, *në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje për sa kohë që referuar natyrës së punimeve të marra përsipër e bëjnë të nevojshme disponimin e licensave.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të 46, pika 1 nenit 53, pika 3 Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 66 ,neni 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe fakteve të mësipërme shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për këtë procedurën e prokurimit e shpall të pavlefshme ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Boshnjaku.B Shpk”, “Pese Vellezerit Shpk” dhe “L.T.E Construction Shpk”, pasi nuk plotëson kërkesat kualifikuese të vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE KEG Shpk me NIUS L91324017H dhe ALKO-IMPEX General Construcion Shpk me NIUS K91326028I, me adresë: KEG Shpk Tiranë,Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33 dhe ALKO-IMPEX General Construcion Shpk, Tiranë,Rruga Reshit Petrela,Kompleksi Usluga,kati i 8,prane stacionit te trenit, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 62,609,425.48 (Gjashtëdhjetëedymilione gjashtëqindënëntëmijëekatërqindënjëzetëe pesë pikëdyzetëetë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri Bashkisë Kolonjë
Adresa Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax +355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173
E-mail bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo me vone se 5 (pesë) ditë nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 28.10.2020

Ankesa: Jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

BASHKIA DEVOLL

Për: IGLI PELLET SHPK ,NIPT L64715601E me adresë: Korce Pogradec Lagjja nr. 1, Zona Industriale Pogradec, Nr. Pasurie 13/124, Zona kadastrale 8581

Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur -Mallra

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72661-09-22-2020

Pelet REF-72665-09-22-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës:“Lende djegese (Dru zjarri dhe Pelet)

Loti 2: “Pelet”

Fondi limit: 8 949 500 (tete milion e nenteqind e dyzet e nente mije e peseqind) leke pa tvsh dhe i ndare sipas loteve:

Loti 2: “Pelet” me fond limit 268 000 (dyqind e gjashtedhjetë e tete mije) leke pa tvsh

Buletini i Njoftimeve Publike [28.09.2020] [77]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. IGLI PELLET SHPK L64715601E

Vlera: 200 000 (dyqind mije) lekë pa tvsh

2. SULOLLARI-KLIMA SHPK K01529003M

Vlera: 213 600 (dyqind e trembedhjetë mije e gjashtë qind) lek pa tvsh

Jane skualifikuar Ofertuesit e meposhtem: NUK KA

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: IGLI PELLET SHPK ,NIPT L64715601E me adresë: Korce Pogradec Lagjia nr. 1, Zona Industriale Pogradec, Nr. Pasurie 13/124, Zona kadastrale 8581, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 200 000 (dyqind mije) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Devoll me adrese Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do vazhdojë, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.11.2020

Ankesa: ka ose jo: JO

DREJTORIA RAJONALE E OSSH FIER

Për: [Bashkim i Operatoreve K.M.K shpk & Caushaj M shpk]

Procedura e prokurimit:Tender i Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-71610-09-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i rrjetit TU me ABC në Fiderin Aranitas, Nënstacioni Pika Shpërndarëse 35/6 kV Ballsh”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): JO

Buletini i Njoftimeve Publike Nr.70 date 14 Shtator 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “AA&P” shpk me Nipt L61713009Q
Vlera 29,635,915 (njëzet e nente milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) leke pa TVSH
2. “EN-EL” shpk me Nipt L22405011A
Pa oferte ekonomike
3. GBK shpk me Nipt: L71620007K
Vlera 28,909,027 (njëzet e tete milion e nëntëqind e nëntë mijë e njëzet e shtatë leke) pa TVSH
4. Bashkim i Operatoreve K.M.K & Caushaj M me Nipt: L78223801E dhe Nipt: L88419801O
Vlera 28,094,252 (njëzet e tetemilion e nentëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) leke pa TVSH
5. “VUHO 2018” shpk me Nipt: L72129028S
Vlera 29,385,309 (njëzet e nente milion e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntë leke) pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- “EN-EL” shpk, refuzohet, pasi :

1. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e kerkuar sipas DST
2. Operatori Ekonomik nuk u paraqit per dorezimin e monstrave
3. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Oferte Ekonomike

- “AA&P” shpk, refuzohet, pasi :

1. Nuk ka paraqitur te gjithë dokumentat e kerkuar sipas DST

- “VUHO 2018” shpk, refuzohet pasi:

1. Nuk ka paraqitur te gjithë dokumentat e kerkuar sipas DST
2. Operatori Ekonomik nuk u paraqit per dorzimin e mostrave

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*Bashkim i Operatoreve “K.M.K shpk & Caushaj M shpk” me seli* Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 28,094,252 (njëzet e tetemilion e nentëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) leke pa TVSH] pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [OSHEE Drejtoria Rajonale Fier Adresa Lagja 1 Maj Rruga Eneriko Veizi] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit të parashikuar ne VKM nr 914 dt 29.12.2014 ndryshuar nr 797 dt 29.12.2017 nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do të anulohet.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05/11/2020

Ankesa: ka ose jo: _jo_____

BASHKIA LIBRAZHD

Për: *ERGI shpk me nr.Nipti K02727229P.*

Me adrese : Elbasan , Autostrada Elbasan – Metalurgji km.3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjja 28 Nentori , rajoni nr.3.

Procedura e prokurimit: “Rikonstruksion dhe shtim prurje ne Ujesjellesin Letem , Njesia Administrative Lunik”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-76714-10-26-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Fondi limit 2 142 483 (dy milion e njeqind e dyzet e dy mije e katerqind e tetedhjetë e tre) leke pa tvsh, afati i realizimit te kontrates 30 dite nga fillimi i punimeve.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik ERGI shpk , perkatesisht me nr.Nipti K02727229P , me oferte ekonomike 2 132 958 (dy million e njeqind e tredhjetë e dy mije e nenteqind e pesedhjetë e tete) leke pa tvsh .

Nuk ka te skualifikuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE ERGI shpk , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2 132 958 (dy million e njeqind e tredhjetë e dy mije e nenteqind e pesedhjetë e tete) leke pa tvsh, pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Librazhd, Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Publike*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.11.2020.

Ankesa: JO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

BASHKIA MAT

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “RUÇI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K37509982G, me seli: *Dibë,r Burrel Lagjja “Partizani”, Sheshi Demokracia, Zona kadastrale nr.1326, Nr. i pasurise 3/6/ND, dhe “RADIKA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J77304705D, me seli: Dibër Peshkopi PESHKOPI L GJOK DOCI.*

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim – Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-76327-10-21-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim i fushës sportive shkolla 28 Nëntori”, me fond limit: 1 032 675.83 (një milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH nga të ardhurat (fonde të tjera), me afat realizimi të punimeve: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 91, datë 26 Tetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “RUÇI” Sh.p.k, me numër Nipt-i: K37509982G, dhe “RADIKA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J77304705D,

Vlera: 1 029 080 (një milion e njëzet e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë pa TVSH

2. Operatorin Ekonomik: “SHAMO-CONSTRUCTION” Sh.p.k.,me numër Nipt-i: L01326020F
Vlera: 1 005 500 (një milion e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “SHAMO-CONSTRUCTION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L01326020F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SHAMO CONSTRUCTION” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” dhe “ç”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:
“1. *Ofertuesi duhet të dorëzojë:*

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
dh. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:
 - *Formulari i Ofertës nuk është paraqitur sipas formatit të Shtojcës 1 në DST, si dhe*
 - *Nuk është paraqitur Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8*

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2018 dhe 2019 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk keni paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave për vitin 2019 nga Bashkia Mat, pasi bazuar në Ekstraktin Historik të QKR-së (*shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së qkr.gov.al*), rezulton si vend tjetër i ushtrimit të aktivitetit dhe në adresën: *Dibër, Macukull, Ndërtimi i Heceve Daznjane, Guri i Zi dhe Shelli*, e cila është shtuar si adresë dytësore më datë 23.10.2019.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

- *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% (që i korrespondon vlerës 516 337.9 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

ose

- *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% (që i korrespondon vlerës 2 065 351.6 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) *Në rast se punimet janë kryer me ente publike:* *Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :*

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*

- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zërat kryesore të punimeve kanë volume të konsiderueshme krahasimore të përcaktuara në këtë prokurim.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, Faturat Tatimore Shitje të paraqitura nuk janë të plotësuar në të gjitha elementët e saj sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor, ku në to mungon vula e shitësit, dhe në 4 (katër) prej tyre, krahas vulës së shitësit mungon dhe nënshkrimi i blerësit.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “a” pika 1/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.4 *Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale e tatim taksave) për punësimin mesatar jo më pak se 7 (shtatë) punonjës për periudhën Shtator 2019 – Shtator 2020, ku përfshihet edhe Drejtuesi Teknik.*

a) *Të paraqiten:*

1. *Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Shtator 2019 – Shtator 2020*
2. *Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën Shtator 2019 – Shtator 2020.*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk është paraqitur vërtetimi nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Shtator 2019 – Shtator 2020.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “c”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

c) *Operatori ekonomik duhet të ketë minimum 2 (dy) punonjës të punësuar, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin:*

- *Teknik ndërtimi - jo më pak se 1 (një) punonjës*

- Saldator – jo më pak se 1 (një) punonjës

* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Dëshmitë e Kualifikimit, Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:
 - Liçenca e punonjësit me specialitetin Teknik ndërtimi është paraqitur fotokopje;
 - Për punonjësit me specialitetin Saldator nuk janë paraqitur Dëshmitë e Kualifikimit që dëshmojnë aftësitë profesionale të tyre.

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “a” pika 1/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit	Sasia
1.	Kamiona vetshkarkues, jo më pak se 7 ton	1 copë
2.	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 – 3 ton	1 copë
3.	Matrapik	1 copë
4.	Depozitë Uji (jo më pak se 2000 litra)	1 copë
5.	Gjenerator	1 copë
6.	Saldatriçe	2 copë
7.	Skeleri (për punime në lartësi)	30 m ²

□ Për vërtetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, të paraqiten:

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara dhe Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (*e vlefshme*).

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se,
 - Nuk disponon Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 – 3 ton, pasi automjeti i paraqitur rezulton të jetë fuoristradë Pickup, dhe me kapacitet mbajtës 820 kg, si dhe
 - Për kamionin e deklaruar nuk është paraqitur fatura për likuidimin e taksave vjetore.

✚ Për këto arsye në zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 53 pika 3, neni 55 pika 2 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 26, 66 të tij,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s'kualifikojë Operatorin Ekonomik, shoqëria "SHAMO CONSTRUCTION" Sh.p.k., pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "RUÇI" Sh.p.k., me numër Nipt-i: K37509982G, me seli: *Dibër, Burrel Lagjja "Partizani", Sheshi Demokracia, Zona kadastrale nr.1326, Nr. i pasurisë 3/6/ND*, dhe "RADIKA" Sh.p.k., me numër Nipt-i: J77304705D, me seli: *Dibër Peshkopi PESHKOPI L GJOK DOCI.*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: 1 029 080 (*një milion e njëzet e nëntë mijë e tetëdhjetë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mat (*Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike*), me adresë: *Sheshi "Ahmet Zogu", Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (*pesë*) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 06.11.2020

Ankesa: Nuk ka patur.

SH.A UJESJELLES KANALIZIME POGRADEC

Për: ELEKTROINVEST NIPTI J62103004A

Procedura e prokurimit: "Blerje dhe sherbim mirembajtje elektropompa"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-75958-10-19-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Mirembajtje dhe permiresim i sistemit Al billing, software dhe hardware

Fondi limit 3.190.000 (tre milion e njeqind e nentedhjet mije) leke pa tvsh

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- ELEKTROINVEST NIPTI J62103004A me oferte 3.150.000 (tre milion e njeqind e pesedhjet mije) leke pa tvsh

Jane skualifikuar

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ELEKTROINVEST NIPTI J62103004A me adrese Rr e "Kavajes" (Brenda Fab se qelqit) Tirane oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3.150.000 (tre milion e njeqind e pesedhjet mijë) leke pa tvsh pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sha Pogradec* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej _____ lek pa tvsh/, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.11.2020

Ankesa: ka ose jo jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Për: GENTIAN SADIKU" P.F

Adresa: TIRANE; ; Kashar; YZBERISH; 3 Rruga Tom Plezha, Pallati Milo,Nr 7, zone kadastrale 3866 pasuri 298/211-N11;

* * *

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim, Mallra, me objekt "Blerje Uniforma dhe këpucë për Akademinë e Sigurisë", Marrëveshjen Kuadër, me disa Operator Ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 2,168,000 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) Lekë, (pa TVSH), me numër reference: REF-76305-10-21-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës së Lotit II me numër reference REF-76310-10-21-2020, "Blerje këpucë, atletë sportive për Akademinë e Sigurisë" me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 374,400 (treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind) Lekë (pa TVSH), Marrëveshjen Kuadër, me disa Operator Ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditëve të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 26.10.2020, Nr.91.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Për lotin II: Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë një operatorë ekonomike me vlerën përkatëse të ofruar:

1) GENTIAN SADIKU" P.F
Emri i plotë i shoqërisë L42314005A
numri i NIPT-it
Vlera: 347,958 (treqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) Lekë, (pa TVSH).
(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:
Nuk ka Ofertues të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operatorë ekonomik i suksesshëm:

1) GENTIAN SADIKU" P.F
Emri i plotë i shoqërisë L42314005A
numri i NIPT-it
Vlera: 347,958 (treqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) Lekë, (pa TVSH).
(me numra dhe fjalë)

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.11.2020
Ankesa: Jo,

DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE GJIROKASTËR

Për: "TEA – D" Sh.P.K., Dhuvjan, Gjirokastër.
Procedura e prokurimit: "Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-75491-10-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje materiale per mirembajtjen e objekteve".

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.89 datë 19 Tetor 2020
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ✓

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ETEM Sh.P.K. J93316642J
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: 1.977.340 (*Njëmilionë e nëntëqint e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqint e dyzetë*)
(me numra dhe fjalë)

2. TEA – D Sh.P.K. K32522629L

Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 1.783.900 (Njëmilionë e shtatëqint e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqint)
(me numra dhe fjalë)

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm: Nuk Ka.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “TEA-D” sh.p.k, Dhuvjan, Gjirokastrë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1.783.900 (Njëmilionë e shtatëqint e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqint), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 1.977.340 (Njëmilionë e nëntëqint e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqint e dyzetë), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 06 Nëntor 2020.

Ankesa: Nuk ka pasur.

MINISTRIA E MBROJTJES

Për: Operatorin ekonomik “Bolt” sh.p.k., me NUIS K91517011V dhe adresë: Ndërtesë me zonë kadastrale 2679, nr. pasurie 60/74-G2, 60/74-G3, 60/74-G4, 60/74-N36, 60/74-N3, 60/74-N27, Kati 0+1+2, Kashar, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: “Kërkesa për propozime” (prokurim publik me mjete elektronike).

Numri i referencës së procedurës: REF-75747-10-16-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje e materialeve bazë për mbështetjen e stërvitjes për vitin 2020”, me fond limit 4,978,640 (katër milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga lidhja e kontratës.

Publikime të mëparshme: Nuk ka pasur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k., me NUIS K91517011V

Vlera: 4,976,240 (katër milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm dhe përkatësisht për këto arsye:
Nuk ka ofertues të skualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "Bolt" sh.p.k., me NUIS K91517011V dhe adresë: Ndërtesë me zonë kadastrale 2679, nr. pasurie 60/74-G2, 60/74-G3, 60/74-G4, 60/74-N36, 60/74-N3, 60/74-N27, Kati 0+1+2, Kashar, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4,976,240 (katër milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme për procedurën me objekt "Blerje e materialeve bazë për mbështetjen e stërvitjes për vitin 2020".

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Prokurimeve dhe Ankandeve), me adresë Rr. e Dibrës (ish Shkolla e Bashkuar) Tiranë me numër kontakti 042 226601, 042 226602 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. (Shënim: *Formulari i sigurimit të kontratës të plotësohet në emër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Komandës së Forcës Tokësore, referuar vlerave për secilën strukturë*).

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 30.10.2020.

Ankesa: Nuk ka pasur.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TE TRANSPORTIT **RRUGOR TIRANË**

Objekti i kontratës: "Pista e testimit praktik të kandidatëve për tu pajisur me Leje Drejtimi, rehabilitim i sheshit funksional, hidroizolim tarrace dhe rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore në DRSHTRR Sarandë "

Për: Operatorin ekonomik "MANE/S" shpk .
Adresa: Vlorë Sarandë SARANDE Lagja 2, Pallati 46,

* * *

Procedura e prokurimit: kërkesë për propozim elektronike,

1. Numri i referencës së procedurës: REF-72202-09-17-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: : "Pista e testimit praktik të kandidatëve për tu pajisur me Leje Drejtimi, rehabilitim i sheshit funksional, hidroizolim tarrace dhe rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore në DRSHTRR Sarandë".

Kohëzgjatja e Kontratës : 3(tre) muaj duke filluar nga data e fillimit të punimeve.

Fondi limit total: 9,014,563 (nëntë milion e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Fondi limit është vënë në dispozicion nga të ardhurat e brendshme të Institucionit.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike 21 Shtator 2020 (Njoftimi i kontrates), Nr. 74.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “AVDULI” shpk. J 66703306 O
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera pa TVSH: 6,899,440 (gjashtë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzetë) lekë pa TVSH.
(me numra dhe fjale)
2. “MANE/S” shpk. NIPT J 64103865 K
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera pa TVSH: 8,174,420 (tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzetë) lekë pa TVSH.
(me numra dhe fjale)
3. “COLOMBO” shpk. NIPT J 82916489 E
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera pa TVSH: 8,915,150 (tetë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “AVDULI” shpk. J 66703306 O
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera pa TVSH: 6,899,440 (gjashtë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzetë) lekë pa TVSH.
2. “COLOMBO” shpk. NIPT J 82916489 E
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera pa TVSH: 8,915,150 (tetë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
(me numra dhe fjale)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Për operatorin ekonomik “AVDULI” shpk
Nga shqyrtimi i ofertës u konstatua që ky ofertues:
Nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit shtojca 11, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pasi:

1. Nuk përmbush kërkesën e pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, nënpika 2.3.4 të dokumentave të tenderit, lidhur me drejtuesit teknik në licencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt për sa parashtrohet si më poshtë :

Pas shqyrtimi dhe verifikimit të dokumentacionit si dhe pas verifikimit zyrtar pranë institucionit të Tatimeve me shkresën nr.19391/1 prot., datë 19.10.2020

(shkresëadministruar në dosjen e tenderit) rezulton që:

- Drejtuese Teknike, Brunilda Avduli e subjektit “Avduli” sh.p.k, rezulton të jetë e punësuar në Entin Publik “Fakulteti i Inxhinieri Ndërtimit” me NIPT J71716001M, me detyrë Laborante, e punësuar me kohë të plotë, me 22 ditë pune pranë këtij fakulteti.
- Drejtues Teknik, Odhisea Koça i subjektit “Avduli” sh.p.k, rezulton të jetë e punësuar në Entin Publik “Fakulteti I Inxhinieri Ndërtimit” me NIPT K51713063I, me detyrë pedagog, e punësuar me kohë të plotë, me 22 ditë pune pranë këtij fakulteti.

Bazuar në “Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin e Rregullores Për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, Kreu IV, citoj....., DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË..... pika dy..... Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit.

- Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.

Sa me sipër Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4., të dokumentave të tenderit, lidhur me drejtuesit teknik në licencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt pasi drejtuesit teknik janë në kundërshtim me VKM-në e sipërcituar.

1. Kontrata e punës së teknikut të ndërtimit, Nderim Rroshi ka ndryshim te paga e punonjësit. Në kontratë paga është përcaktuar 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) dhe në listëpagesa është më e vogël, 28,000 (njëzetë e tetë mijë)...pra deklarohet paga me e vogël në Tatime.
Sa më sipër Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6., të dokumentave të tenderit, lidhur me kontratën e punës së Teknikut të Ndërtimit .
2. Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor për kontrata të lidhura jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, nuk është i plotë, mungon fjalia e fundit në kundërshtim me pikën 2.3.17., të dokumentave të tenderit, lidhur me Vetëdeklarimin.
Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që Autoriteti Kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesëve të mundshëm për përgatitjen e ofertave sipas formatit të APP-së. Në hartimin e këtyre dokumenteve, Autoriteti Kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit e si rrjedhojë edhe operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta pa ndryshuar apo hequr fjali nga shtojcat dhe deklaratat.
Sa më sipër Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.17., të dokumentave të tenderit, lidhur me Vetëdeklarimin.

2. Për operatorin ekonomik “ COLOMBO”shpk

1. Operatori ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit shtojca 11, “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit” dhe “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pasi: Në listën e dokumentave të paraqitura nga ky operator ekonomik rezulton të jetë vetëm një dokument. Formulari i ofertës ekonomike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin “MANE/S”shpk në adresë: Vlorë Sarandë SARANDE Lagjja 2, Pallati 46, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH prej 8,174,420 (tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzetë) lekë është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Rr. “Muhedin Llagani”, Nr.10, Tiranë*, kopjen e sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 23.10.2020.

Ankesa: Ka.

Pas marrjes së njoftimit të kualifikimit nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, është paraqitur një ankesë pranë Autoritetit Kontraktor:

- Nga operatori ekonomik “AVDULI“ shpk është paraqitur Formulari i ankesës të datës 27.10.2020 pranë protokollit të DPSHTRR-së, protokolluar me tonën nr.20605 prot. datë 30.10.2020, lidhur me s’kualifikimin e këtij operatori ekonomik.
- Me Urdhër nr.710 datë 30.10.2020 është pezulluar procedura e prokurimit me objektin e sipërpërmendur dhe janë përcaktuar zyrtarët që do të shqyrtojnë ankesën e operatorit ekonomik.
- Me shkresën nr.20605/1 prot. datë 03.11.2020 është dhënë vendimi mbi ankesën nga zyrtarët që kanë shqyrtuar ankesën, dhe me shkresën nr.20605/2 prot. datë 03.11.2020 i është kthyer përgjigje Operatorit Ekonomik “AVDULI“ shpk, duke mos e marrë në konsideratë ankesën e këtij operatori ekonomik.

Procedura e prokurimit ka qëndruar e pezulluar në sistemin elektronik të APP-së duke respektuar afatet ligjore të ankimimit pranë KPP-së.

- Pas përgjigjes së marrë nga Autoriteti Kontraktor, operatori ekonomik “AVDULI“ shpk., Nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë institucionit të KPP-së.
- Nga Autoriteti Kontraktor janë respektuar afatet ligjore të ankimimit për këtë objekt. Pas konfirmimit të faqes zyrtare të institucionit të KPP-së rezulton që, operatori Ekonomik “AVDULI” shpk pas përgjigjes së marrë pranë Autoritetit Kontraktor mbi ankesën e tij të ushtruar, nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë institucionit të KPP-së.

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Për: OE EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI NIPT K91727010A
Adresa: Njesia Bashkiake Nr.9, Bulevardi Zogu i I, Godina Nr.2, Ap.7, Shk.1, kati 3,
Tiranë

Procedura e prokurimit: Tender i hapur elektronik

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-71131-09-09-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi, asfaltimi + rrjeti inxhinierik i rrugës nr.1, Lëkurës Sarandë Lot 1+2” me fond limit: 385.388.979,17 (treqind e tetëdhjetë e pesë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI NIPT K91727010A, Vlera 190.102.649,39 (njqind e nentedhjte milion e njqind e dy mije e gjashteqind e dyzete e nente presje tridhjte e nente) lekë pa tvsh,
2. BOE ARIFAJ sh.p.k., -NIPT- J76418907K& DENIS-05 shpk NIPT- K51518029B - & Xhast shpk NIPT K12512837I Vlera 191.974.929 (njqind e nentedhjte e nje milion e nenteqind e shtatedhjte e kater mije e nenteqind e njezete e nente) lekë pa tvsh,
3. OE EUROTEOREMA PEQIN NIPT J61905050M, Vlera 204.000.000 (dyqind e kater million) leke pa tvsh,
4. OE 2 T shpk, NIPT K01731001M & BE - IS shpk, NIPT- K71412003A, Vlera 274.649.290,20 (dyqind e shtatedhjte e kater million e gjashteqind e dyzete e nente mije e dyqind e nentedhjte presje njezete) leke pa tvsh,
5. OE CURRI NIPT J67902718S, Vlera 290.553.808,30 (dyqind e nentedhjte million e peseqind e pesedhjte e tre mije e teteqind e tete presje tridhjte) leke pa tvsh,
6. OE ALBA KONSTRUKSION shpk NIPT J61812013R, Vlera 362.284.726 (treqind e gjashtedhjte e dy million e dyqind e tetedhjte e kater mije e shtateqind e njezete e gjashte) leke pa tvsh.
7. BOE S I R E T A 2F shpk NIPT K51501008J & EURO-ALB shpk NIPT K66613407H, Vlera 266 666 666 (dyqind e gjashtedhjte e gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhjte e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhjte e gjashte) lekë pa tvsh,
8. BOE ARTI shpk NIPT J64103808P&JODY-KOMPANY shpk, NIPT J94824803M&R. S. M shpk, NIPT K32203002I Vlera 195 814 354,14 (njqind e nentedhjte e pese million e teteqind e katermbedhjte mije e treqind e pesedhjte e kater presje katermbedhjte) leke pa tvsh,
9. BOE GRAND KONSTRUKSION M shpk & "SHKELQIMI 07" shpk, NIPT K68121808W, Vlera 197 193 530 (njqind e nentedhjte e shtate million e njqind e nentedhjte e tre mije e peseqind e tridhjte) leke pa tvsh,
10. OE DABAR NIPT L62409033I, Vlera 0 (Nuk ka paraqitur oferte ekonomike)
11. OE AGI KONS shpk NIPT K21622001M, Vlera 227 720 182 (dyqind e njezete e shtate million e shtateqind e njezete mije e njqind e tetedhjte e dy) leke pa tvsh,

12. BOE ED KONSTRUKSION shpk NIPT K61625001I & NIEM shpk NIPT K36609610Q & VIANTE Konstruksion shpk, NIPT K47103804L, Vlera 191 022 425.3 (njqind e nendhjte e nje million e njezete e dy mije e katerqind e njezete e pese presje tre) leke pa tvsh,
13. BOE MANE/S shpk, NIPT J64103865K & BOSHNJAKU. B shpk, NIPT K72627402H & MF INVEST GROUP shpk, NIPT L71830010R, Vlera 206 450 024,7 (dyqind e gjashte million e katerqind e pesedhjte mije e njezete e kater presje shtate) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE DABAR NIPT L62409033I per arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion per te vertetuar kapacitetin teknik, financiar dhe professional.
2. BOE S I R E T A 2F shpk NIPT K51501008J & EURO-ALB shpk NIPT K66613407H, per arsye se nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT "Përvojë të suksesshme ne realizimin pune te ngjashme",
3. BOE GRAND KONSTRUKSION M shpk & "SHKELQIMI 07" shpk, NIPT K68121808W per arsye se nuk ploteson kriteret e veçanta për kualifikim qe lidhen me kapacitetet organizative, në mënyrë kumulative,
4. OE AGI KONS shpk NIPT K21622001M per arsye se nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT "Përvojë të suksesshme ne realizimin pune te ngjashme",
5. BOE MANE/S shpk, NIPT J64103865K & BOSHNJAKU. B shpk, NIPT K72627402H & MF INVEST GROUP shpk, NIPT L71830010R per arsye se nuk ploteson piken 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT "Përvojë të suksesshme ne realizimin pune te ngjashme".
6. BOE ARTI shpk NIPT J64103808P&JODY-KOMPANY shpk, NIPT J94824803M&R. S. M shpk, NIPT K32203002I, per arsye se nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT "Përvojë të suksesshme ne realizimin pune te ngjashme.
7. BOE ED KONSTRUKSION shpk NIPT K61625001I & NIEM shpk NIPT K36609610Q & VIANTE Konstruksion shpk, NIPT K47103804L, per arsye se nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT "Përvojë të suksesshme ne realizimin pune te ngjashme"

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë OE EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI NIPT K91727010A, me *adrese*: Njesia Bashkiake Nr.9, Bulevardi Zogu i I, Godina Nr.2, Ap.7, Shk.1, kati 3, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të 190.102.649,39 (njqind e nentedhjte milion e njqind e dy mije e gjashteqind e dyzete e nente presje tridhjte e nente) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Rr. "Sami Frashëri", nr. 10, Tirana, Albania, Phone: 00355 42 235 597/8 (int. 151), Fax: 00355 42 234 885, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 191.974.929 (njqind e nentedhjte e nje milion e nenteqind e shtatedhjte e kater mije e nenteqind e njezete e nente) lekë pa tvsh,, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 15.10.2020

Ankesa: Ka

Kane marre pergjigje në datë 27.10.2020

DREJTORIA RAJONALE E OSSH SHKODËR

Për: [BOE „NIKA“ sh.p.k. & „GRIALD“ sh.p.k. Adresa: Nika: Lagja Vasil Shanto, Rruga Bulevardi Skenderbeu, pas kinema milenium, Shkoder, Griald: Rruga e Uzines, Lagja e Re, Kukes]

Procedura e prokurimit: PROCEDURE E HAPUR, me Objekt „Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinave"Barbulloje 22"t 3, "Fishte 1", "Fishte 2", Fideri 11 Kallmet, N/St Lezhe, "F-13 Ujesjelles Ajror", "Blinisht 1", "Blinisht 2", "Blinisht"

Loti I-rë	Vendgrumbullimi Nr.1	741 480	145,28	107 722 214
Loti II-të	Vendgrumbullimi Nr.2	404 928	149,76	60 642 017
Loti III-të	Vendgrumbullimi Nr.3	122 248	153,6	18 777 293
Loti IV-tër	Vendgrumbullimi Nr.4	205 128	151,68	31 113 815

Në vleftën fillestare nuk përfshihet TVSH-ja e cila do të shtohet në momentin e shitjes.

- Shitja e “Skorjeve të bakrit (mbeturinë)” bëhet në vendndodhje, në gjëndjen faktike ekzistuese.
- Fiton ofertuesi me vlerën me të lartë.
- Ankandi do të fillojë me kërkesat e blerjes në total ku përfshihet e gjithë sasia e “Skorjes bakrit (mbeturinë)” dhe në pamundësi të kësaj kërkesë, për çdo Lot.

Çdo person fizik e juridik i interesuar për blerjen e “Skorjes së bakrit (mbeturinë)” duhet të paraqesë:

- Kërkesë me shkrim pranë autoritetit shitës për blerje të “Skorjes bakrit (mbeturinë).
- Dokumentin që vërteton konfirmimin e pagesës prej 2 % të vleftës të ankandit, të

arkëtuar në llogarinë bankare të Albakrit sh.a sipas “ Dokumentave standarte”
- Dokumentat e indentifikimit konform “Dokumentave standarte”.

7- Vendi i zhvillimit të ankandit: në “Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me adresë: Bulevardi: Dëshmorët e Kombit, Nr. 3; Tiranë, me datën 16.12.2020, në orën 12⁰⁰.

8- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: data 16.12.2020, ora 12⁰⁰.

9- Informacione më të hollësishme gjenden në dokumentat e ankandit, të cilat mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës “Albbaker” sh,a në likuidim, Tiranë, kundrejt pagesës prej 2000 lekë, çdo ditë pune nga ora 9⁰⁰-14⁰⁰.

Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për ofertë;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Proçes-verbali i Njesisë së ankandit.

10. Kërkesa për pjesëmarrje,dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

BASHKIA KAMËZ **NJOFTIM ANKANDI**

1. Autoriteti shites: Bashkia KAMËZ
(adresa, nr. Tel: - “Bulevardi Blu” nr.492 Kamez Tiranë,- +355 47 200 177)
2. Data e zhvillimit te ankandit: 14.12.2020 ora 10.00
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit : Procedura e hapur
4. Objekti i Shitjes: Shitje per skrap e mjeteve te Bashkise Kamez dhe Ndermarjes Pastrim Gjelberim e Treg te nxjerra jashte perdorimit
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: Shitja publike me ankand per skrap e mjeteve te Bashkise Kamez dhe Ndermarjes Pastrim Gjelberim e Treg te nxjerra jashte perdorimit

Nr,	Emertimi	Njesia	Sasia	Pesha e mjetit (kg)
1	Mjeti “NISSAN “ petrol 4x4	cope	1	1,378
2	Mjeti “FADROME” Komatsu	cope	1	8,160
4	Mjeti “Mercedes BENZ “ T-2 407-D	cope	1	3,450
5	Mjeti “VOLKSWAGEN” T-4	cope	1	3,000
6	Mjeti “Mercedes BENZ”	cope	1	2,210
7	Mjeti Kamion FIAT “IVECO”	cope	1	6,970

6. Vlera fillestare: 362,419.20 (treqind e gjashtëdhjete e dy mijë e katerqind e nentembedhjete pike njezet) leke.
7. Vendi i zhvillimit te ankandit: Bashkia Kamez, Salla e Keshillit, kati III-te
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 14.12.2020 ora 10.00
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:
Dokumentet e ankandit mund te trerhiqen prane autoritetit shites
Dokumente me pagesë:
- | | | | | |
|---------|---------|------|-------|--------------------------|
| | Po | x | Jo | <input type="checkbox"/> |
| Nëse Po | Monedha | leke | Çmimi | 500 |
- Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:
- Formulari i njoftimit;
 - Kërkesa për pjesëmarrje;
 - Formulari i ofertës;
 - Ftesa për oferte;
 - Formulari i njoftimit te fituesit;
 - Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
 - Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.
10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ASHK-së
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti shites: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ASHK-së
Tiranë, Tel:04/229406
2. Data e zhvillimit te ankandit 15/12/2020
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit : Ankand me “Procedure te hapur”
4. Objekti i Shitjes: “Shitje skrap automjetesh të ish Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujatshme”.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: “Shitje skrap automjetesh të ish Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujatshme”. Pesha 11,030 kg.
6. Vlera fillestare : 275,750 (dyqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë

7.Vendi i zhvillimit te ankandit: Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së,
Rruga: “Dora d’Istria”, Tiranë

8.Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

Data 15/12/2020, ora 11.00

9.Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

Po Jo x

Informacion me te hollesishem do te gjeni ne dokumentat e ankandit ne fjale.

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Proceverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

NJOFTIME FITUESI ANKANDI

KËSHILLI I QARKUT SHKODËR **NJOFTIM FITUES ANKANDI**

Ref:Urdhëri i Ankandit Nr. 367 Prot. datë 26.08.2020

Për: Arjet Hoti, Person Fizik, me numër NIPT K26623001F (Adresa: Lagjia: Ahmet Haxhia, Rr. Livadhe, Rajoni Nr.1, nr.19, Shkodër)

* * *

Procedura e ankandit: E hapur

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: Objekti “Shitje e një automjeti për pjesë këmbimi”. Objekti i shitjes, përkatësisht Automjeti Tip Toyota Land Cruiser i vitit 1999, me naftë, me numër shasie JT711PJA507009072 është nxjerrë jashtë përdorimi. Në bazë të konstatimeve të Komisionit të Vlerësimit të Automjeteve datë 26.11.2019 dhe Komisionit të Posaçëm të Vlerësimit të Ankandit Publik nr.250/2 prot. Datë 22/06/2020 është i papërdorshëm si automjet. Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni dhe inxhinieri mekanik më datë 26.11.2019, rezulton se është i pamundur riparimi dhe kthimi në gjendje në pune të tij, për shkak se motorri nuk funksionon, si dhe ka probleme të tjera teknike (probleme në transmisionin prapa, në sistemin e drejtimit, në kamio dhe diferencial, si dhe probleme me dinamon dhe rrjetin elektrik). Statusi i Mjetit “çrregjistrim i përhershëm”. Peshë pa ngarkesë e automjetit është 1600 kg.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.82, datë 05.10.2020 (fq.422-423).

Njoftojme se, kanë qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

“Arjet Hoti” Person Fizik
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 200,000 (dyqind mijë) lekë pa T.V.SH.

K26623001F
numri i NIPT-it

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm: Nuk ka ofertues të skualifikuar
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Arjet Hoti, Person Fizik, me numër NIPT K26623001F (Adresa: Lagjia: Ahmet Haxhia, Rr. Livadhe, Rajoni Nr.1, nr.19, Shkodër) se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 200,000 (dyqind mijë) lekë pa T.V.SH. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Jeni i lutur të paraqisni pranë Këshilli i Qarkut Shkodër (Rr.28 Nëntori, Shkodër) sigurimin e kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të zbatohen hapat proceduralë të parashikuar në legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.11.2020.

Ankesa: Nuk ka pasur

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIM FITUES ANKANDI

BOE "Duraku - A" sh.p.k & "Pisha" sh.p.k.

"Duraku - A" sh.p.k me NIPT L 82817202 A, me adresë: Lagjja "Mengël", Labinot Fushë - Elbasan

"Pisha" sh.p.k. me NIPT K 12526207 V A, me adresë : Rruga Labinot Fushë-Elbasan, km 1
Procedura e ankandit: "Ankand i Hapur".

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij : Loti I - Shitje material drusor në këmbë për sasinë totale prej 1,380 (njëmijë e treqind e tetëdhjetë) m³, me vlerë fillestare 666,960 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa t.v.sh., me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri].

Njoftojmë se në këtë procedurë të zhvilluar më datë 03.11.2020 ora 11.00, kanë qenë pjesëmarrës këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE "Duraku - A" sh.p.k. me NIPT L 82817202 A & "Pisha" sh.p.k. me NIPT K 12526207 V A

Ofertues të s'kualifikuar nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : BOE "Duraku - A" sh.p.k & "Pisha" sh.p.k. ; "Duraku - A" sh.p.k me NIPT L 82817202 A, me adresë: Lagjja "Mengël", Labinot Fushë - Elbasan; "Pisha" sh.p.k. me NIPT K 12526207 V A, me adresë : Rruga Labinot Fushë - Elbasan, km 1, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 666,960 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa t.v.sh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

I.1 Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan, me adresë: rruga "Qemal Stafa", Elbasan, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç parashikohet në dokumentat e ankandit.

I.2

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 39 të ligjit nr. 9874, date 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.11.2020.

Ankesa: Nuk ka pasur.

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIM FITUES ANKANDI

Për:

BOE "K.Korra" sh.p.k & "Pisha" sh.p.k. & "Luli 06" sh.p.k.

“K.Korra” sh.p.k me NIPT K 12526208 G, me adresë: Rruga Elbasan - Librazhd, km 6, ZK 3864, pasuria nr.776

"Pisha" sh.p.k. me NIPT K 12526207 V A, me adresë : Rruga Labinot Fushë-Elbasan, km 1

"Luli 06" sh.p.k. me NIPT K 63127202 E me adresë : Fshati Kuqan, Shirgjan, Elbasan

Procedura e ankandit: “Ankand i Hapur”.

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij : Loti II - Shitje material drusor në këmbë për sasinë totale prej 1,041 (njëmijë e dyzet e një) m³, me vlerë fillestare 523,240 (pesëqind e njëzet e tremijë e dyqind e dyzet) lekë pa t.v.sh., me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri].

Njoftojmë se në këtë procedurë të zhvilluar më datë 03.11.2020 ora 11.30, kanë qenë pjesëmarrës këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “K.Korra” sh.p.k. me NIPT K 12526208 G & "Pisha" sh.p.k. me NIPT K 12526207 V A & "Luli 06" sh.p.k. me NIPT K 63127202 E

Ofertues të s’kualifikuar nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : BOE “K.Korra” sh.p.k & "Pisha" sh.p.k. & "Luli 06" sh.p.k.; “Duraku - A” sh.p.k me NIPT L 82817202 A, me adresë: Lagjja "Mengël", Labinot Fushë - Elbasan; "Pisha" sh.p.k. me NIPT K 12526207 V A, me adresë : Rruga Labinot Fushë - Elbasan, km 1, Elbasan; "Luli 06" sh.p.k. me NIPT K 63127202 E me adresë : Fshati Kuqan, Shirgjan, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 523,240 (pesëqind e njëzet e tremijë e dyqind e dyzet) lekë pa t.v.sh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan, me adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç parashikohet në dokumentat e ankandit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 39 të ligjit nr. 9874, date 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.11.2020.

Ankesa: Nuk ka pasur.

BASHKIA LIBRAZHD
NJOFTIM FITUES ANKANDI

1. Autoriteti shites: BASHKIA LIBRAZHD (adresa, nr. tel): Qyteti Librazhd Nr.Tel & fax. 0514 / 2352
2. Data e zhvillimit të ankandit: 10.11.2019 ora 10.00
3. Procedura e ankandit: (Procedurë e hapur)

4. Objekti ankandit: “Për dhënie në përdorim të sipërfaqes pyjore/kullosore”

5. Vlera fillestare pa T.V.SH. sipas loteve ishte:

- Loti I. 37 800 (Tridhjetëeshtatëmijëetëqint) lekë pa tvsh.
- Loti IV. 7 500 (Shtatëmijëepesëqind) lekë pa tvsh
- Loti V. 20 300 (Njëzetmijëetëqint) lekë pa tvsh

6. Vlera e shpallur fituese pa T.V.Sh. është:

- Loti I. 37 900 (Tridhjetëeshtatëmijëenëntëqint) lekë pa tvsh.
- Loti IV. 7 500 (Shtatëmijëepesëqind) lekë pa tvsh
- Loti V. 20 300 (Njëzetmijëetëqint) lekë pa tvsh

Ofertuesi i shpallur fitues sipas loteve është:

1. Për lotin I : Subjekti Albert HOXHA me NIPT L37612601M me adresë: Fshati Xhyrë,Njesia Administrative Hotolisht,Librazhd
2. Për lotin IV: Subjekti Steliano FAQOLLI me NIPT M08321601C adresë: Vehçan,Njesia Administrative Hotolisht,Librazhd
3. Për lotin V: Subjekti Ymer LILA me NIPT K87713603R me adresë: Librazhd

7. Ofertues të skualifikuar Nuk ka.

8. Ofertuesi i shpallur fitues ftohet të paraqesë pranë Bashkisë Librazhd (Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave) kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat standarte të ankandit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga shpallja në Buletimin e Njoftimeve Publike.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorezuar me një vlerë prej (nuk ka ofertues të dytë), siç parashikohet në nenin 39 të ligjit për prokurimet publike nr. 9874 datë 14.02.2008, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit të fituesit është bërë më datë 10.11.2020

UZINA LËNDËVE PLASËSE ELBASAN **NJOFTIM FITUES ANKANDI**

Për: *Operatori ekonomik : ELIS LENA, person fizik*

Adresa: Vaqarr, Tiranë

* * *

Procedura e ankandit: *[Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]Nr. 4*

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: *“Shitje Lllamarinë Inoksi, Lllamarinë Çeliku, Prokate Inoksi, Prokate Çeliku, Profile Çeliku, Saraçineska të ndryshme (çelik + gize)”, e*

ndarë në lote, Lotin II - me objekt Shitje Lllamarinë Çeliku, për sasinë totale 4783 kg (katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre kilogram).

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 85 date 12.10.2020.

Njoftojme se, kane qene pjesemarrës ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.ELIS LENA, person fizik

L22201008A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 179 500 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh
(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

SKA

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ELIS LENA” me adresë Vaqarr, Tiranë , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 179 500(njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) leke pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Uzinës së Lëndëve Plasëse Mjekës, Elbasan kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr. 9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.11.2020

Ankesa: Ska

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

UZINA LËNDËVE PLASËSE ELBASAN

NJOFTIM FITUES ANKANDI

Për: Operatori ekonomik : ELIS LENA, person fizik

Adresa: Vaqarr, Tiranë

* * *

Procedura e ankandit: [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]Nr. 4

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: “Shitje Lllamarinë Inoksi, Lllamarinë Çeliku, Prokate Inoksi, Prokate Çeliku, Profile Çeliku, Saraçineska të ndryshme (çelik + gize)”, e ndarë në lote , Loti IV- me objekt Shitje Prokate Çeliku, për sasinë totale 7799.8 kg (shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje tetë kilogram).

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 85 date 12.10.2020.

Njoftojme se, kane qene pjesemarrës ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.ELIS LENA, person fizik

L22201008A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 290 200(dyqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind)lekë pa Tvsh

(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
SKA

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik "ELIS LENA" me adrese Vaqarr, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 290 200 (dyqind e nëntëdhjet mijë e dyqind) leke pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Uzinës së Lëndëve Plasëse Mjekës, Elbasan* kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr. 9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.11.2020

Ankesa: Ska

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

UZINA LËNDËVE PLASËSE ELBASAN
NJOFTIM FITUES ANKANDI

Për: *Operatori ekonomik : ELIS LENA, person fizik*

Adresa: Vaqarr, Tiranë

* * *

Procedura e ankandit: [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]Nr. 4

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: "Shitje Lllamarinë Inoksi, Lllamarinë Çeliku, Prokate Inoksi, Prokate Çeliku, Profile Çeliku, Saraçineska të ndryshme (çelik + gize)", ndarë në lote, Loti V- me objekt Shitje Profile Çeliku, për sasinë totale 18759 kg (tetëmbëdhjet mijë e shtatëqind e pesëdhjet e nëntë kilogram).

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 85 date 12.10.2020.

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.ELIS LENA, person fizik

L22201008A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 706 000 (shtatëqind e gjashtë mijë) lekë pa Tvsh

(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
SKA

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik “ELIS LENA” me adrese VAqarr, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 706 000(*shtatëqind e gjashtë mijë*) *leke pa TVSH* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Uzinës së Lëndëve Plasëse Mjekës, Elbasan* kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr. 9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.11.2020

Ankesa: Ska

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

KONTRATA TË LIDHURA ANKANDI

BASHKIA MIRDITË **NJOFTIM KONTRATË E LIDHUR**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Mirditë

Adresa Sheshi “Abat Doçi” Rrëshen

Tel/Fax: (00355) (0) 2162233

E-mail: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

Faqja e Internetit www.bashkiamirdite.gov.al

2. Lloji i procedurës: Ankand Publik i Hapur

3. Data e zhvillimit të ankandit 06.07.2020

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Dhënie me qira të pasurisë së paluajtshme sipas udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016” Per Rregullat, Procedurat e Kerkimit, të Shqyrtimit të Miratimit të Kërkesave për Dhënie në Përdorim të Fondit pyjor dhe Kullorur Publik”: që i përket ekonomisë pyjore: Kunorë -Valmor, me ngastrat nr.93c, 94c, 94d, 94e, 95d, 94a, 94b, me sipërfaqe prej 5.28644 ha në pronësi të Bashkisë Mirditë, “Për qëllimi pushimi argetimi” me afat përdorimi (qiraje), 10 (dhjetë) vite në numrat e pasurisë nr.402, zk.2327, vol.1, faqe 203 me çertifikatë pronësie nr.1009652, me veprimtari: Për qëllime pushimi, argëtimi”

5. Vlera Fillestare e Dhënies me Qira 366 157.6 (Treqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë pike gjashtë) lekë/vit.

6. Vlera totale e kontratës: 406 157 (katerqind e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) leke pa Tvsh në 1 (një) vit.

7. Data e Lidhjes së Kontratës me noteri: 21.09.2020 (Nr.0450 Rep, Nr.279 Kol.)

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit

Emri: “KUNORA GROUP” Shpk, Nr. NIPT: L98901001H

Adresa: Lezhë, Rrëshen, Rruga e Arbrit, Pallati 5 katesh, H.1, Kati 4, 11/1, Zona kadastrale 3224, Nr.pasurie 8/223+1-11/1 Mirditë.

ANULLIME ANKANDI

DREJTORIA RAJONALE E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT FIER **NJOFTIM ANULLIM ANKANDI**

Në datën 11.11.2020, ora 11:00, në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Fier, me qëndër në Vlorë, u zhvillua Ankandi i hapur, me Nr. Ref 3/A-2020, me objekt shitje sipas njoftimit të publikuar në Buletinin e APP Nr.89, datë 19.10.2020, faqe 473-474.

Në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e ankandit u konstatua se dokumentat e Ankandit nuk ishin tërhequr nga asnjë subjekt, dhe nuk u paraqit asnjë kandidat/ofertues.

Sa më sipër e ndodhur në kushtet e mungesës së konkurrencës, në mbështetje të Kreut VI, të VKM nr.1719, datë 17.12.2008, "Per miratimin e rregullave të ankandit publik", Autoriteti Shitës vendosi përsëritjen e procedurës për të gjitha lotet si me poshtë:

LOTI NR	EMERTIMI I LOTIT	VLERA ME TVSH
1-	PORTOFOLA DHE ÇANTA ME MBISHKRIME "LUIS VITON" "D&G", "BURRBERY" etj.	3 456.00
2-	SYZE OPTIKE KINEZE	237 734.40
3-	SPRAY KROSKOTI PER MAKINA	768.00
4-	SKRAP BAKRI	16 320.00
5-	DORASHKA PUNE DHE JELEK FOSFORESHENT	4 928.00
6-	PIJE TE NDRYSHME IMPORTI	7 827.20
7-	VERERA TE NDRYSHME	896.00
8-	PIJE TE NDRYSHME ALKOLIKE PRODHIM VENDI	3 689.60
9-	DETERGJENTE TE NDRYSHME	3 596.29
10-	PIJE ALKOLIKE TE NDRYSHME	4 812.80
11-	VAJ MOTORRI DHE ANTIFRIZE	163.84
12-	ARKIVOL DHE KURORA ME LULE	2 375.68
13-	KINKALERI TE NDRYSHME	2 928.64
14-	KONFEKSIONE TE NDRYSHME	2 756.61
15-	PAKETA CIGARE TE NDRYSHME	3 883.01
16-	MATERIAL TESUT (STOK) PER VESHJE KEMBE	475 545.60

DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK **NJOFTIM ANULLIM ANKANDI**

- Autoriteti shites: Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik
(adresa, nr. tel) Pallati nr.4, Rruga "Skënderbej", Tiranë, Nr. Tel. + 4 2222756
- Data e zhvillimit te ankandit: 17.11.2020
- Lloji i Procedurës standarde te ankandit: Proçedurë e hapur
- Objekti i Shitjes: " SHITJE E MALLRAVE TË MBETUR STOK"

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Shiten pjesë këmbimi për automjete të tipit ZUK dhe IFA, pjesë këmbimi për ashensorë dhe elementë radiatorë llamarine
6. Vlera fillestare: 1 034 551 (një milion e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një)
7. Vendi i zhvillimit të ankandit: Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik
Rruga “Skënderbej”, Pallati Nr.4, Kati 2, Tiranë
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:
17.11.2020 Ora 10:00
9. Arsyeja e anulimit: Mungesa e konkurrencës

Autoriteti shitës njofton se deri në afatin e përcaktuar datë 17.11.2020 Ora 10:00 të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 91 datë 26.10.2020 nuk u paraqit asnjë ofertë. Për vazhdimin e procedurës duhet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në mbështetje të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për Miratimin e Rregullave të Ankandit Publik” e ndryshuar, autoriteti shitës, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, për shkak mungesës së konkurrencës vendosi anulimin e procedurës së ankandit për të rishpallur një procedurë të re.

TË TJERA ANKANDE

KREU I KATËRT

Buletini i

ofertave të qirave

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Njoftojmë shtyrjen e datës së konkurrimit publik për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për pasuritë nr.134, nr.136, nr.137/21, nr.137/22, nr.139, nr.148, nr.469, Zona Kadastrale 1667, të cilat ndodhen në Fushë Maliq, Bashkia Maliq, Qarku Korçë, nga data 8.12.2020, ora 11.00 publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.91, datë 26.10.2020 në datën 9.12.2020, ora 11.00.

Ky njoftim bëhet në zbatim të Vendimit nr. 373, datë 20.06.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, Kreu IV “Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, pika 5.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**NJOFTIM PËR DHËNIE ME QERA**

Në zbatim të Vendimit nr.373, datë 20.06.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, Kreu IV “Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, pika 4.1, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural njofton fillimin e procesit të dhënies me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, pasuritë nr.63/33, nr.63/37, Zona Kadastrale 3019, të cilat ndodhen në Njësinë Administrative Poliçan, Bashkia Poliçan, Qarku Berat.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE NË QARKUN VLORE**

1. Fillimin e procedurës për dhënien me qira, me konkurrim publik, të tokës bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe prej 5.5 ha, pasuritë nr.3/9, nr.4/1, nr.4/2, nr.5/2, Zona Kadastrale 2264, ndodhur në Krane, Delvinë, Qarku Vlorë.
2. Dhënia me qira e tokës bujqësore bëhet me qëllim dhënien në përdorim të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për zhvillimin e veprimtarive bujqësore dhe/ose prodhim blegtoral.
3. Konkurrimi do të zhvillohet më datë 6.1.2021, ora 11.00, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, adresa BLV “Dëshmorët e Kombit”, nr.2, Tiranë, Salla e Mbledhjeve Kati i II-të.
4. Çmimi fillestar i qirasë, për fillimin e konkurrimit, është 114,000 (njëqind e katërmbëdhjetë mijë) lekë/vit.
5. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie të jetë në përputhje me parashikimet e Kreut VI, të Vendimit nr. 373, datë 20.06.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, në varësi të kulturës bujqësore ose specie e bimëve me të cilat do të lidhet kjo veprimtari.

6. Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, me dokumentacionin si vijon :
 - Vetëdeklarimin për ekstraktin e regjistrit tregtar të personit fizik apo juridik, që ka paraqitur ofertën;
 - Vërtetimin e kapacitetit financiar për jo më pak se 20 % të vlerës totale të investimit të propozuar në planin e biznesit nëpërmjet:
 - i. financimit dhe kreditimit nga ana e instituteve bankare ose financiare;
 - ii. kapaciteteve financiare të vetë investitorit, të provuara dhe siç rezultojnë nga pasqyrat financiare të audituara e të depozituara pranë administratës tatimore, të 3 viteve të fundit, kur kjo është e mundur, ose, nëse është themeluar pas këtij afati, të viteve/it të fundit;
 - iii. marrëveshje huaje në përputhje me Kodin Civil.
 - Planin e biznesit të aktivitetit që do të ushtrohet, sipas modelit të miratuar me Udhëzimin nr.12, datë 30.07.2018, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të hartuar nga specialistë mjedisi të licencuar;
 - Projektin e investimit në infrastrukturë kur kërkuesi parashikon ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale apo objekte në funksion të agroturizmit, për të cilat kërkohet leje ndërtimi dhe kategoria e resursit ndryshon nga tokë bujqësore në truall, i përgatitur nga specialistë të licencuar, në përputhje me dokumentet e planifikimit të territorit;
 - Afatin e përdorimit të tokës për qiramarrje, në varësi edhe të kulturave bujqësore ose specieve të bimëve që do të mbillen;
 - Vetëdeklarimin që nuk ka detyrime financiare ndaj organeve tatimore qendrore e vendore, nuk është në ndjekje penale, nuk ka detyrime ndaj qiradhënësit si dhe nuk është në konflikt interesi me qiradhënësin;
 - Vlerën e qirasë vjetore të ofruar për të gjithë sipërfaqen e tokës bujqësore, objekt qiradhënie;
 - Sigurimin e ofertës në vlerën e qirasë së një muaji, duke e llogaritur me vlerën e shpallur në njoftimin për konkurrim.
7. Ofertat paraqiten në një zarf të mbyllur jo transparent, i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të MBZHR-së (Kati i parë).
8. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.12, datë 30.07.2018, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për organizimin dhe funksionimin e bordit të qiradhënies, të komisionit të shqyrtimit të ankesave, kriteret e vlerësimit dhe mënyra e përlllogaritjes së ofertave, si edhe kriteret dhe mënyra e llogaritjes së vlerës së qirasë, në procesin e marrjes me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit”, Kreu III “Kriteret e vlerësimit dhe mënyra e përlllogaritjes së ofertave”.
9. Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopjo të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të marrin pjesë në çeljen e ofertave. Asnjë konkurrues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurimit në bazë të shtetësisë.
10. Do të mbahet parasysh zbatimi i Ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr.9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore, i ndryshuar.
11. Subjektet e interesuar mund të kërkojnë informacion për procedurën konkurruese pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në postën elektronike: info@bujqesia.gov.al.

12. Ky njoftim do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në ambjentet e Njesisë Administrative Finiq, Bashkisë Finiq, Agjencisë Rajonale të Ekstencionit Bujqësor Lushnje, në faqen zyrtare të MBZHR-së dhe në dy gazeta kombëtare.

KONCESIONE / PARTNERITET
PUBLIK PRIVAT

PROCEDURA KONKURRUESE PËR **LEJE MINERARE**

NJOFTIME TË TJERA

BANKA E SHQIPËRISË **TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje letër format A4 për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,500,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje letër format A4 për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 09 Dhjetor 2020, ora 11:30, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË **TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje e programit dhe 3 licencave të tij, për regjistrimin e inventarit dixhital të koleksionit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 870,300 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e

pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje e programit dhe 3 licencave të tij, për regjistrimin e inventarit dixhital të koleksionit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 09 Dhjetor 2020, ora 13:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË **TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje e suportit vjetor të produktit ‘Fire Eye’”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,657,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje e suportit vjetor të produktit ‘Fire Eye’”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 09 Dhjetor 2020, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

SPITALI PSIKIATRIK “DR. SADIK DINCI” **Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit Nr.511, datë 13.12.2011 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik” Spitali Psikiatrik “Dr. Sadik Dinci”, Elbasan shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- Sanitare

Kandidatët e interesuar duhet të plotesojë këto kriteret:

- Të ketë mbaruar arsimin tetë ose nëntë vjeçar ose arsimin e mesëm
- Të ketë eksperinc pune në këtë pozicion përben avantazh
- Të ketë aftesi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup

Personat e interesuar duhet te paraqesin keto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim
- Diplomë + list notash të noterizuar
- CV (Curriculum Vitae)
- Raport mjeko-ligjor
- Fotokopje të kartës së indentitetit
- Çertifikatë familjare
- Librezë pune.
- Vërtetim nga Prokuroria/Gjykata.
- Vërtetim banimi.

Te interesuarit duhet te paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik Elbasan deri më date 27.11.2020 ora 09.00.

Konkurimi do të kryhet në datë 30.11.2020 ora 10.00 pranë Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik Dr.”Sadik Dinçi “Elbasan.

UNIVERSITETI I MJEKËSISË

Njoftim për vend të lirë pune

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe në urdhrin e Rektorit nr. 124, datë 17.11.2020 shpall konkursin për pozicionin e punës 1 (një) vend vakant për “Personel Akademik” në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Onkologji, në Fakultetin e Mjekësisë”, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë vijon:

- Kandidatët konkurrentë për pozicionin e punës vakant “Personel Akademik” 1 (një) vend në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Onkologji, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, duhet të plotësojnë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotëroj gjuhen shqipe të shkruar e të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
6. Të jetë diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, dega Mjekësi e Përgjithëshme, studime universitare brenda ose jashtë vendit;
7. Të ketë mbaruar studimet universitare me note mesatare mbi 8 (tetë);
8. Të zotërojë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore (Anglisht, Frengjisht, Italisht, Gjermanisht, Spanjisht);
9. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;

Kritere specifike:

1. Të disponojë diploma të nivelit të tretë të studimeve mjekësore;
2. Të ketë eksperiencë pune në Onkologji mbi 15 vite;
3. Të ketë eksperiencë mësim dhënie në lëndën e Onkologjisë mbi 4-5 vite;
4. Të ketë licencën për ushtrimin e profesionit në specialitetin përkatës nga Urdhëri i Mjekëve;

Kritere preferenciale:

1. Preferohen kandidatë që kanë marrë pjesë në veprimtari kërkimore dhe shkencore në fushën e Onkologjisë.
2. Preferohen kandidatë me dy ose më shumë gjuhë të huaja.
3. Preferohen të jetë mjek që e njih mirë shërbimin ku punon.
4. Të ketë kualifikime apo specializime ndërkombëtare në Onkologji.

Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrim (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimet e tyre në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuar (për secilin program përkatës studimit);
5. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare ose të gradave dhe titujve (fotokopje të noteruara). Per diplomat master ose PhD të marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent ose vërtetim që janë në proces njohje;
6. Dëshmi të pjesmarrjes në konferenca apo seminare etj.
7. Kopje e noterizuar e licencës për ushtrimin individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri i Mjekëve.
8. Kopje e noterizuar e dëshmimeve të njohjes së gjuhëve të huaja;
9. Të paktën dy referenca nga punëdhënësit e fundit ose trupa akademike, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
10. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
11. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj;
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
13. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda tri muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
14. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015;
15. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi penaliteti) të marrë brenda tri muajve të fundit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, pranë zyrës së Protokoll-Arkivës, në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, pranë QSUT, Nr. 232, Tiranë)

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: 23.11.2020 - 08.12.2020 (10 ditë pune)

A. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Vlerësimi do të bëhet sipas formularit të vlerësimit të kandidatëve për personel akademik i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i publikuar ne faqen zyrtare www.umed.edu.al

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@umed.edu.al

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të VKM Nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për vendin e lirë të punës në pozicionin:

Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kukës.

Kandidati/ja që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Shkenca Sociale /Ekonomike/Juridike/ Natyrore;
4. Niveli i arsimimit /Master shkencor;
5. Të ketë eksperiencë pune të paktën 3 vite;
6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
7. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 01.12.2020, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 02.12.2020, do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkursi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e Shërbimit Social Shtetëror që gjendet në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Njohuri mbi Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
2. Njohuri mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
3. Njohuri mbi strategjitë kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
4. Njohuri mbi ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
5. Njohuri mbi ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”

6. Ligj Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërise”.
7. Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, mund t’i gjeni në adresën www.sherbimisocial.gov.al